

MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM

midis

Kolegji-t “Universum”

dhe

Single Parent Association

Qëllimi i marrëveshjes

Me këtë marrëveshje palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin e mirë dhe gatishmërinë për bashkëpunim. Kolegji “Universum” në kuadër të misionit të saj për ndërtim dhe zhvillim të komunitetit në Kosovë, si institucion privat i Arsimit të Lartë, ka vendosur që në bashkëpunim me Association for Single Parents, të kontribuojë në edukimin e nënave vetëushqyese, me qëllim të rritjes së barazisë gjinore, fuqizimit ekonomik të grave në Kosovë, rritjen e qasjes së nënave vetëushqyese në edukim dhe rritjen e kapacitetit të tyre konkurrues në tregun e punës. Ky kontribut i Kolegjit “Universum” bëhet në kuadër të Objektivës 1, 4 dhe 5 të Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm – me qëllim të uljes së varfërisë përmes edukimit.

Palët e kësaj marrëveshje, zotohen për bashkëpunim në fusha të ndryshme, që ndërlidhen me aktivitetet e edukimit dhe avancimin e nënave vetëushqyese, përmes qasjes në arsimim dhe zhvillim të mëtutjeshëm pa diskriminim, mbështetur në parime të Ligjit për Arsimin e Lartë si dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 11, paragrafi 1, pika (f) dhe nenit 12, paragrafi 2, pika (d) e Statutit të Kolegjit “Universum” si dhe në pajtim me vlerësimin e komisionit të formuar për ndarjen e bursave në kuadër bashkëpunimit nder institucional Kolegji Universum ka marrë vendim për ndarjen e 4 (pesë) bursave në vlerë 100% (njëqind përqind) për studime themelore Bachelor, për nënat vetëushqyese, të propozuar nga Single Parent Association.

Kolegji Universum është i obliguar që me rastin e përzgjedhjes së nënave vetushqyese përfituese nga **Single Parent Association**, t'i ndajë 4 bursa studimi për vitin akademik 2021/2022 (në vlerë 100%, në drejtime të caktuara që Kolegji Universum ofron për studime):

- në programin **Shkenca Kompjuterike**
- në programin **Biznes dhe Menaxhment**
- në programin **Shkenca Politike**
- në programin **Juridik**

Kriteret

Bursa shfrytëzohet për studime në Kolegjin Universum, pra për Bursat e plota studenti nuk ka ndonjë obligim financiar të kështit mujor për të gjithë ciklin e studimeve. Bursa vlen për tri vite të studimit sipas kriterëve të nënshkruara me kontratë për studime.


Modifikimi/ Përfundimi


Çfarëdo ndryshimi/ plotësim i dispozitave të kësaj marrëveshje do të bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët e marrëveshjes. Ndryshimet/ plotësimet do të përcillen me një tekst të arsyeshmërisë për ndryshimin/ plotësimin që i dorëzohet secilës palë të marrëveshjes. Çdo mosmarrëveshje do të zgjidhet me frymën e mirëkuptimit në mes të dy palëve.

Hyrja në fuqi

Marrëveshja hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit të saj nga e palëve të kësaj marrëveshjes.

Palët nënshkruese:

Single Parent Association

Arjeta Gashi – Drejtore Ekzekutive
Datë: 09 / 11 / 2021

Kolegji UNIVERSUM

Arlinda Qehaja – Kolegji Universum

Datë: 09 / 11 / 2021